

Elona SHEHU (SHAHINI)
 Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
 elonashahini@umsh.edu.al

Ndikimi i Reformave Arsimore dhe nivelit Arsimor në normën e papunësisë

Abstrakt

Ky studim synon të tregojë problematikat dhe rrishtë që kanë sjellë reformat në fushën e arsimit, lidhur kjo me numrin e studentëve të rregjistruar në universitetet publike dhe ato private në Republikën e Shqipërisë dhe me mundësinë e integritit të tyre në tregun e punës. Bazuar në metodologjitë e përdorura dhe të dhënat e grumbulluara, është kryer një analizë mbi numrin e nxënësve që kanë mbaruar arsimin e mesëm dhe atyre që kanë filluar dhe përfunduar arsimin e lartë gjatë viteve 1992-2012. Duke pasur parasysh evoluimin që ka pësuar sistemi arsimor në vendin tonë këto 23 vitet e fundit, mund të thuhet që janë duke u kryer reforma të përshtatshme arsimore. Nëse shikojmë numrin e studentëve të cilët kanë mbaruar arsimin e lartë në RSH dhe normën e papunësisë për këtë grupmoshë, shihet se ka ende shumë për të përmirësuar në politikat arsimore dhe në infrastrukturën akademike. Megjithë numrin e madh të studentëve që kanë mbaruar arsimin e lartë publik apo privat, pjesa më e madhe e tyre nuk plotësojnë kushtet minimale të njohurive në fushën ku kanë studjuar, kjo edhe për arsye të mungesës së praktikës efektive që ofrojnë Institucionet e Arsimit të Lartë në vendin tonë.

Analizat e mëposhtme do të na tregojnë se ecuria e numrit të të rregjistruarve dhe të diplomuarve në universitetet shqiptare ka ardhur në paralelizëm me reformat e ndjekura vitet e fundit në këtë fushë. Janë plotësuar 200 pyetsorë, nga individë të zgjedhur rastësisht në qytetin e Tiranës. Këto pyetsorë konsistojnë në mbledhjen e informacionit lidhur me shkollën e mesme, universitetin dhe nëse është i punësuar në një institucion publik, privat ose i papunë, të dhënat do të paraqiten në përqindje ndaj totalit të grupit të zgjedhur. Kjo shpërndarje rastësore na ndihmon të arrihet në përfundimin se në varësi të kushteve ekonomike, sociale dhe politike, të përcaktohet trendi që kanë këto grupmosha të specifikuar sipas gjinisë, për të qënë pjesë e sistemit arsimor dhe më pas pjesë e tregut të punës.

Fjalët Kyçe: Reforma në arsim, Norma e papunësisë, Procesi i Bolonjës, Sistemi i provimeve, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Cikli i parë i studimeve, Arsimi i Lartë Publik, Arsimi i Lartë privat.

Përmbajtja e materialit

1. Nivelet e Arsimit në Republikën e Shqipërisë
2. Arsimi në këndvështrimin e reformave
3. Nevojat për të krijuar një Sistem të ri Arsimit Kombëtar
Mënyra e shpërndarjes së kuotave në Arsimin e Lartë Publik
4. Lidhja e nivelit arsimor me nivelin e punësimit
5. Konkluzione dhe Rekomandime

1. Nivelet e Arsimit në Republikën e Shqipërisë

Reforma e administrimit në sektorin e arsimit synon konsiderimin e kërkimit shkencor si një ndër instrumentat e rëndësishëm të menaxhimit të sistemit, në nivelin e organeve drejtuese dhe të vetë shkollave. Vlerësimet e brëndshme dhe ato ndërkombëtare kanë rivlerësuar pamjaftueshmërinë e zhvillimit institucional dhe të strukturave organizative të kërkimit shkencor në fushën e arsimit, për rrjedhojë edhe domosdoshmërinë e zhvillimit dhe rinovimit të këtij komponenti. Aktualisht, shtrohet kërkesa për ristrukturimin e kërkimit në nivel parauniversitar e universitar, nëpërmjet forcimit të qëndrave kërkimore ekzistuese dhe krijimit të një rrjeti efikas institucionesh kuaziqeveritare.

Kjo do të bëjë të mundur edhe krijimin e një sistemi racional të menaxhimit dhe financimit të kërkimit shkencor dhe të zhvillimit në të gjithë sferën e arsimit. Zhvillimi i burimeve njerëzore përbën një nga detyrat më të rëndësishme të organeve qëndrore të arsimit. Analiza e këtij problemi në nivel qeveritar, sipas studimeve të organizmave prestigjioze të vendit e të huaja, tregon pamjaftueshmërinë e një sistemi të menaxhimit dhe zhvillimit të këtij sektori, përfshirë këtu dhe të metodave standarte të politikës së personelit. Në këtë kontekst, edhe vetë Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, nuk është e imunizuar nga kjo dukuri. Përmirësimet strukturore dhe funksionale të vëna në jetë kohët e fundit, pritet të japin impakt pozitiv edhe në përmirësimin e këtij treguesi.

Politika e këtij programi konsiston në sigurimin e kushteve të barabarta për pjesëmarrjen e arsimit dhe detyruar, për të gjithë fëmijët e moshës. Realizimin e reformës arsimore në përmbajtje dhe metodë, duke hartuar kurrikulën e re dhe duke zbatuar gjerësisht standardet e përmbajtjes dhe arritjes. Përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, nëpërmjet rritjes së motivimit të mësuesve dhe trajnimit e kualifikimit të tyre. Zhvillimin sasior dhe cilësor të Arsimit Parashkollor. Matjen e performancës së sistemit arsimor nëpërmjet vlerësimeve dhe provimeve. Politika e këtij programi konsiston në rritjen e tërheqjes së nxënësve që mbarojnë arsimin e detyrueshëm në arsimin e mesëm të përgjithshëm, krijimin e kushteve optimale pune në shkolla, reformimin e përmbajtjes dhe metodave, përmirësimin e teknologjisë mësimore dhe motivimit të mësuesve, duke synuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Politika e këtij programi konsiston në reformimin e Arsimit të Mesëm Teknik-Profesional dhe Social-Kulturor sipas nevojave të tregut të punës dhe zhvillimeve

të zonave të veçanta të vendit. Rritjen e numrit të nxënësve që studiojnë në këto kategori arsimit, përmes krijimit të mundësive të reja, hartimit të kurrikulave të reja në tërësi dhe me dy nivele në veçanti për arsimin profesional, si dhe zgjerimit të bashkëpunimit me biznesin dhe komunitetin. Përgatitjen më të mirë profesionale e nxënësve, duke ngritur reparte të reja të zhvillimit të praktikave profesionale, kabinete të ndryshme dhe pajisja e atyre ekzistuese me makineri e teknologji të nevojshme. Përshtatjen e strukturës së arsimit profesional dhe atij social-kulturor me sistemin e detyruar 9-vjeçar të arsimit.

Politika e këtij programi konsiston në parimet dhe qëllimet e Deklaratës së Bolonjës, për të arritur standardet evropiane. Në mënyrë të veçantë, prioritetet janë zgjerimi i kapaciteteve të arsimit të lartë universitar dhe pasuniversitar për t'iu përgjigjur nevojave të shoqërisë për kualifikim, rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet përmirësimit të kurrikulave dhe pasurimit të anës laboratorike dhe pajisjeve teknike, realizimi i autonomisë institucionale dhe financiare, përmirësimi i sistemit të bursave për t'i shpërndarë ato sipas meritave dhe nivelit ekonomik.

2. Arsimi në këndvështrimin e reformave

Arsimi është një nga fushat më të rëndësishme të çdo shoqërie dhe të çdo sistemi. Përmes arsimit shoqëritë dhe kombet u transmetojnë pjesëtarëve të tyre dijen, kulturën, trashëgiminë kulturore, vlerat përmes të cilave shkon përpara shoqëria. Është edhe një nga fushat që jo vetëm i prin shoqërisë, por edhe ndikohet fuqishëm prej saj dhe ndryshimeve shoqërore. Fakti që sistemet e arsimit janë në ndryshim të përhershëm, nuk tregon paqëndrueshmëri, përkundrazi, ato shërbejnë për t'iu përshtatur sa më mirë ndryshimit të shoqërisë. Ashtu siç ka ndodhur edhe në sistemin tonë shkollor, ndryshimet e shpeshta të bëra këto 23 vitet e fundit, kanë treguar se arsimi është munduar të përshtatet sa të mundë me ndryshimet sociale, ekonomike dhe politike të vendit, por edhe me ato të rajonit. Këto ndryshime duke mos qenë shumë të studiuara dhe duke qenë se janë kryer në një terren shumë pak të favorshëm nga gjendja në të cilën sistemi arsimor vjen, jo gjithmonë kanë dhënë frytet e duhura dhe shpesh janë perceptuar nga shoqëria si eksperimente.

Arsimi është një proces që i hap rrugën së nesërme së vendit dhe garanton një të sotme më të mirë. Si i tillë arsimi duhet të mbajë parasysh dy parime themelore: Së pari edukimin, dhe së dyti arsimimin. Të dy konceptet janë dhe duhet të jenë të përcaktuara mirë: edukimi si një proces i zhvillimit të personalitetit, dhe arsimimi, si një proces i zhvillimit mental të subjektit. Shqipëria ka 23 vjet që mbështetet në reforma arsimore që zëvendësojnë njëra-tjetrën, pa arritur asnjëherë të bëhet analiza e dështimit apo arritjeve të secilës prej tyre. Arsimi shqiptar ka vuajtur, më shumë se çdo sektor tjetër, populizimin e politikës dhe mungesën e standardeve. Në këto kushte sot ky sistem është ndër më të kritikuarit nga institucionet ndërkombëtare dhe ka nevojë për një përmirësim konceptual.

Teknologjia e sotme të krijon me mjera mundësi për të lexuar, për të zgjedhur dhe mbi të gjitha për të shkurtuar kohën e leximit. Ndërkohë presioni që bëhet për notat është i madh, sepse diploma, në një vend në zhvillim si Shqipëria, konsiderohet si

mjet parësor për të gjetur një vend pune. Ndaj prindërit ushtrojnë presion te fëmijët për të marrë sa më shumë nota të mira, me synim për të marrë një diplomë që është fortësisht e dëshirueshme në tregun e punës. Pra një rikonceptim i edukimit, krijon mundësi të mëdha për arsimimin. Koha sot kërkon një brez të mësuar që të mendojë lirisht, të tolerojë dhe të kuptojë aftësitë e dëshirat e veta, që të jetë i aftë të ndërtojë një model të tijin, në mënyrë që të përshtatet me realitetin e tregut dhe të jetës shoqërore. Kjo mendoj se duhet të jetë rruga e ndërtimit të sistemit tonë arsimor. Çdo individ, sipas prirjeve dhe dëshirave të tij, duhet të marrë më tej edhe shkallët e tjera të arsimimit. Që të arrihet një edukim i tillë arsimor, kërkohet të ndërtohen kurrikula të veçanta në sistemin universitar e pasuniversitar që të mundësojnë kuptimin dhe qëllimin e edukimit.

Nga disa eksperimente që janë bërë nga universitete me emër në botë, rezultojnë se sa më e madhe të jetë liria e individit në punë, aq më shumë ai do të priret të punojë me dëshirë dhe pasion. Puna me dëshirë dhe pasion çon në rritjen e shkallës së produktivitetit. Sipas këtyre studimeve, është konstatuar se individi promovohet më shumë në punë, jo duke e vlerësuar materialisht sesa duke e lënë të lirë të veprojë sipas asaj që ai e dëshiron apo e ka pasion. Por që të arrihet deri këtu, duhet edukuar për të qenë i tillë. Brezi i fëmijëve të sotëm do të jetë brezi i zotërimit të aftësive të mëdha zhvilluese të vendit.

Pas krizës globale u vu re që edhe në Shqipëri tregjet ekzistente që mbanin gjallë ciklin e konsumit po lodheshin e po ezauroheshin. Shifrat që vijnë nga industria e ndërtuesve, nga ajo e fasonëve, nga turizmi e nga shërbime të tjera tregonin se rënia e rritjes (ndonjëherë vetë rënia) jo vetëm që është reale dhe e ndjeshme, po kishte rezik të ishte e pakthyeshme në nivelet e mëparshme. Ndërsa këto tregje ngushtoheshin për arsye të kuptueshme, kapitali kërkonte hapësirë ku të mund të zgjerohej dhe për këtë arsye lobbying-u i biznesit ka bërë presion të fortë në kanale publike e jopublike, mediatike e politike që të hapen tregje të reja, sidomos ai i arsimit të lartë. Që prej dhënies së licencave për hapjen e universiteteve Private, akreditimi i tyre, duket sikur i është futur një rrugë që as nuk është diskutuar publikisht e politikisht, dhe as kritikuar, duke mos parë se ç'kosto oportune ka. Përpjekja e paraqitur si një hap më tej për njësimin e sistemit universitar shqiptar me atë european nëpërmjet Procesit të Bolonjës, ka nxjerrë në dukje disa probleme.

Problemi i parë, ai më i rëndësishmi qëndron i shpallur në vetë Kartën e Bolonjës, ku efektivisht arsimit i lartë sanksionohet si një mjet i riprodhimit ideologjik. E gjithë kjo farsë ndodhi pikërisht aty ku në 1088 u krijua i pari universitet european që u shkëput prej kishës e prej religjionit për t'iu dedikuar dijes. Sipas kartës së firmosur nga ministrat e Këshillit të Europës, Procesi i Bolonjës do të ndihmonte modernizimin e arsimit të lartë european, do të krijonte një arenë të përbashkët të arsimit të lartë duke njësuar programet e diplomat, në mënyrë që rezultati i studimeve të ishte më i përshtatshëm për tregun e punës, duke rritur punësimin e të diplomuarve dhe duke shkurtuar gjatësinë e studimeve. Universiteti, që sipas përkufizimit duhej të qe bashkësi e studiuesve dhe e studentëve, u vendos në funksion të tregut dhe u kthye në bashkësi të sipërmarrësve (pronarët privatë apo shteti), menaxherëve doktrinarë (pedagogët) dhe klientëve (studentët). E gjithësesi, edhe po të mos

bëhet kjo kritikë, e po të thuhet se universiteti na qenka vendi më i përshtatshëm për të përgatitur ustallarë për punishtet e ndërmarrjeve, nuk duhet harruar fakti se tregjet kanë dinamikën e tyre të cilat nuk do të mund të reflektohen kurrë aty për aty në përgatitjen individuale, kështu që në çdo ndryshim të tregut do të krijohet një armatë të papunësh që do të duhet të bëjnë edhe një master tjetër për t'u përshtatur me risitë.

Problemi i dytë është mentaliteti i kontrollit që mbizotëron gjithë Procesin e Bolonjës. Është e vetëkuptueshme që heqja dorë prej lirisë akademike që kish prodhuar pikën më të fortë të akademisë europiane, pra larinë, do të prodhonte një të tillë mentalitet të nënshtruar tek studiuesit e tek studentët. Hapat të cilët individit duhet të ndjekë për t'u formuar akademikisht tashmë janë të vendosur nga tjetërkush, ndërkohë që në vetë universitetet, programet bachelor, apo programet master janë shëndërruar në fenomene të rëndomta. Programi neoliberal, kaq shumë i fokusuar tek liria, në emër të lirisë së tregut për t'u zhvilluar duket se ka shkelur lirinë e individit për të qenë i veçantë në formimin e vet akademik, madje edhe lirinë e akademisë për të zgjedhur mënyrën e vet të vënies në funksion të dijes.

Problemi i rëndësishëm dhe që ndikon në rritjen e papërshtatshme të kostos së arsimit në vendin tonë është edhe zbatimi i skemës së vetfinancimit të ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve, duke financuar nga buxheti i shtetit vetëm studimet e ciklit të parë, Bachelor. Kjo në radhë të parë bie në kontradiktë me qëllimin që ka ky proces për të përgatitur njerëz për tregun e punës, sepse tregu i punës kërkon më shumë kualifikim se sa programi bachelor. Në radhë të dytë shihet qartë se shteti zvogëlon periudhën e kujdesit për qytetarët, duke paguar vetëm 3 vjet arsim të lartë për secilin. Pra, nën mbulesën e një politike mirëbërëse, po i jep publikut një shërbim më të shkurtër, të pamjaftueshëm dhe siç ka treguar koha më pak cilësor, ndërkohë që e detyron të paguajë vetë specializimin, apo Masterin.

Eksperimentimi në arsim nuk është diçka e keqe, por kur ky eksperimentim kalon caqet hapësinore dhe kohore, atëherë ai bëhet i dëmshëm dhe ndikon negativisht. Reformat e fundit në arsim dhe debatet që i kanë shoqëruar atë dëshmojnë për një rritje të ndërgjegjësimit të shoqërisë për problemet e arsimit dhe shkollës. Këto probleme duket se i përkasin gjithë shoqërisë dhe jo vetëm një pjese të saj. Reformimi i arsimit tashmë ka prekur të gjithë sistemin arsimor dhe duket se po kulmon me ligjin për arsimin e lartë. Duke qenë se intensiteti i reformave ka qenë i madh dhe koha e kryerjes së tyre, relativisht e shkurtër, janë vënë re dhe po dalin në pah shumë problematika. Është e kuptueshme që vetëm me një reformim të tillë problemet nuk mund të zgjidheshin përnjëherë. Kështu dolën në pah problematikat të cilat në disa raste, nëse nuk trajtohen me seriozitetin e duhur mund të lënë pasoja të rënda në arsimimin e brezave.

Edhe pse duket sikur në shkollë nuk ka ndodhur ndonjë ndryshim i madh, kurrikula e re dhe reformimi tërësor i sistemit parauniversitar ka bërë një revolucion në fushën e arsimit në vendin tonë. Ky reformim nuk duhet parë i ndarë, d.m.th, i copëzuar dhe i rastësishëm, pasi nëse e shohim kështu nuk do të arrijmë të perceptojmë të gjithë ndryshimin që është kryer. Duke filluar me sistemin 9-vjeçar, gjimnazin e ri,

altertekstin, Maturën Shtetërore, etj.

Reformat e kryera shpeshherë e kanë gjetur të papërgatitur stafin akademik dhe nxënësit, për të përballuar gjithë këto ndryshime. Nëse synimi dhe arritja kryesore e kurrikulës së re dhe reformës ka qenë ndryshimi i konceptimit në arsim, pra vënia në qendër e nxënësit, kjo jo nga të gjithë mësuesit është kuptuar, ose është kuptuar në mënyrë sipërfaqësore. Të vendosësh nxënësin në qendër të mësimi nuk do të thotë të mjaftohesh duke përdorur disa teknika mësimdhënieje që në literaturën pedagogjike njihen si “teknika të të mësuarit me në qendër nxënësi”, por duhet të ndryshohet mendësia e mësimdhënies, duhet ndryshuar këndvështrimi. Ende sot, ka mësues që e shohin nxënësin si objekt dhe jo si subjekt. Harrojnë se tek çdo individ ka një veçori të cilën sistemi arsimor dhe veçanërisht mësuesi duhet ta vërë në dukje. Tek nxënësit shohin problemin dhe jo zgjidhjen; nxënësit i vënë në dukje dobësitë, por jo arritjet. Ky këndvështrim, edhe pse nuk është keqdashës bëhet shkak për krijimin e situatave të pakëndshme në mësim.

Reforma e MSH (Maturës Shtetërore), e cila me konceptimin e saj shumë bashkëkohor synoi të vinte në barazpeshë vlerat e secilit, u kthye në të kundërtën e saj si rezultat i një “pakujdesie” të vogël, keqadministrimit. Nëse kjo reformë po shfaq problematikën e saj, kjo nuk do të thotë se duhet të kthehemi pas, por të shohim shkaqet e problemeve dhe të gjejmë rrugëzgjdhje më të mira.

Problematika më e bujshme dhe më shqetësuese, sa herë që fillonte viti shkollor kishte të bënte me tekstet. Mungesa e tyre, shitja në mënyrë të paligjshme, cilësia e dobët, sasia e pamjaftueshme dhe mbi të gjitha përmbajtja e tyre dhe ngarkesa e madhe me mangësi në aparatën pedagogjike, u kthyen në një problem tjetër që shoqëroi shkollën shqiptare gjatë viteve të tranzicionit. Reforma e Altertekstit në arsimin parauniversitar mendohet se ka zgjidhurnjë sere problemesh të ngritura. Nuk mund të pretendohet se cilësia dhe niveli shkencor apo pedagogjik i tyre arriti standardet më të larta, por kjo reformë e futi arsimin në një rrugë të mbarë dhe ndikoi shumë në ndryshimin e perceptimit të tekstit, jo si mjeti më i rëndësishëm i mësimdhënies, por si një mjet i nevojshëm për nxënësin.

Ajo që duket se mbetet e porealizuar në këtë reformë, ka të bëjë me mësuesin. Për sa kohë do të ketë mësues që për probleme të ndryshme apo paqartësi apo edhe gabime shkencore do të shfaqësohen se “kështu e ka teksti”, mund të thuhet me bindje se reforma nuk është kuptuar si dhe sa duhet. Problematika e re që shfaq reforma e altertekstit ka të bëjë me tekstet e përkthyer, të cilat vërtet u përkasin shkencave natyrore dhe si të tilla sigurisht që mund të jenë më të mira në cilësi dhe përmbajtje se tekstet që mund të përgatiten nga specialistët shqiptarë, por nuk duhet harruar tradita e vendit nga vijnë këto tekste dhe mbi të gjitha, përkthimi problematik, që shpesh është më shumë sesa problematik dhe jociësor. Shtëpitë botuese nga dëshira për të qënë sa më konkurrese në treg harrojnë se nuk kanë të bëjnë me një produkt konsumi, por me një material të rëndësishëm për formimin e brezave.

Ajo që mund të dëmtojë seriozisht këtë reformë dhe rrjedhimisht edhe sistemin arsimor, ka të bëjë me interesat klienteliste të shtëpive botuese dhe autorëve të

teksteve. Për miratimin e teksteve është më mirë të zbatohet një procedurë më e hapur dhe transparente, duke përfshirë më shumë mësuesit si zbatues dhe njohës më të mirë të programeve dhe problematikave shkollore. Kështu mund të shmanget çdo ndikim nga jashtë dhe monopolizim i dëmshëm.

Duke qenë se arsimi është ndër sektorët shtetërorë të punësimit, politika e ka shfrytëzuar këtë mundësi për të krijuar përfitime elektorale. Ndikimi i saj ka bërë që edhe një mësues i thjeshtë të mos e ndiejë veten të qetë kur çdo shtator i duhet të presë me ankth emërimet, lëvizjet, largimet apo problematikën që del nga fillimi i vitit shkollor. Mësuesi është ndoshta i vetmi profesion që ende vlerësohet si në komunizëm. Të gjithë të barabartë, dhe të gjithë të paguar njëllor. Atëherë përse duhet një mësues të përpiqet për të ngritur anën e tij profesionale? Vetëm për kënaqësi, kur për punë dhe mund të ndryshëm, lodhje dhe përgjegjësi jo të barartë të gjithë mësuesit paguhet njëllor, sipas një skeme që duket absurde. Skemë që ka funksionuar vetëm në socializëm për kategorizimin e mësuesve sipas vjetërsisë, kur dihet se të jesh më i vjetër në një punë nuk do të thote se je më i mirë.

Kjo ka bërë që të gjitha reformat, ndryshimet, zhvillimet në arsim të përcillen me indiferentizëm nga një pjesë e mësuesve, pasi për ta mjafton të kenë një diplomë, një mik, një njohje e kështu me rradhë dhe pozicioni si dhe paga nuk ndyshojnë. Ky është një faktor që sot profesionin e mësuesit e kërkojnë nxënës jo shumë cilësorë, sepse e dinë që me të mbaruar shkollën do të gjendet një vend ku të rrinë rehat për gati 40 vjet të tjerë. Kjo praktikë duhet ndaluar, sepse po krijon probleme serioze në arsim. Mësuesi si çdo profesionist duhet motivuar të rritë profesionalizmin e tij, por nga ana tjetër duhet vlerësuar dhe i duhet dhënë një status i cili të mos shkelet lehtë nga erërat e ndryshimeve politike.

Një tjetër aspekt që lidhet me përgatitjen e mësuesve ka të bëjë me të rinjtë dhe studentët të cilët e zgjedhin këtë profesion. Universitetet dhe shkollat duhet të krijojnë ura bashkëpunimi për t'u dhënë këtyre të rinjve aftësitë dhe shprehitë e nevojshme, pasi njohuritë dhe dijet i marrin gjatë studimit. Të gjithë e dimë se sa e vështirë është të kalosh nga teoria që merret në shkolla në praktikën konkrete, në terren. Për këtë duhen praktika, të cilat nuk mungojnë në programet e studimit të universiteteve për degët e mësuesisë, por realizimi i tyre dhe organizimi kanë vend për përmirësim. Studentët nuk mund të marrin në shkollë gjithë njohuritë që u duhen për të qenë profesionistë të mirë, aq më tepër kur pjesa më e madhe e pedagogëve janë të shpëputur nga sistemi parauniversitar, por pranë shkollave ata mund të mësojnë më shumë për atë që u duhet.

Kjo arrihet duke ia besuar këtë detyrë një mësuesi specialist dhe jo rastësisë, siç ndodh rëndom. Për këtë duhet menduar si nga universiteti edhe nga Drejtoritë arsimore, për të krijuar mentorë dhe mësues cilësorë në praktika, të cilët sigurojnë duhen vlerësuar. Praktikë e mirë dhe shumë e vlefshme do të ishte edhe punësimi me kohë të pjesshme pranë shkollave të studentëve të sapodiplomuar për të fituar aftësitë dhe shprehitë e punës, por duke e konsideruar këtë si periudhë praktike aktive që mund të bëhet pa pagesë ose me fonde të tjera.

Që nga viti 2005 u aplikua shkollimi i detyrueshëm nëntëvjeçar, në tri cikle, kurse shkollimi i mesëm u bë vetëm tre vjet. Sipas të dhënave të prezentuara, një pjesë e vogël e populates (5-7%) që janë mbi moshën 15-vjeç, janë analfabet ose persona vetëm me shkollë filllore. Ne nuk duam që reformat të na sjellin analfabet me diploma. Në këtë mënyrë koha kërkon një zgjidhje të shpejtë për problemet aktuale të infrastrukturës tonë. Duhet kërkuar përmeshja e angazhimeve rreth zhvillimit të saj, si dhe një rishikim i objektivave dhe treguesve të përcaktuara në të, për shkak të institucionit dhe të keq menaxhimit të tij.

Më poshtë paraqitet grafikisht luhatja e nxënësve të diplomuar në shkollat e mesme në të gjithë Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional. Nga analiza grafike dalim në përfundimin se luhatja në rritje dhe në rënie e numrit të nxënësve të diplomuar vijnë si pasojë e faktorëve politik, ekonomik dhe social, të cilët çojnë në marrjen e masave ose reformave në sistemin arsimor por edhe në zgjedhjet që bëjnë individët si konsumator të këtij shërbimi, qoftë ai publik ose privat. Vitet ku luhatja paraqitet me ritme më të larta janë vitet 1991-1992, ku me përmbyshjen e sistemit u arrit një shkallë e caktuar lirie veprimi dhe zgjedhjeje. Vitet 1997-1998, si pasojë e krizave politike dhe ekonomike shkaktuan rënie të dukshme të të diplomuarve në arsimin e mesëm dhe si pasojë e mungesës së sigurisë në vend u shoqëruan me braktisje të shkollave nga nxënësit dhe kryesisht të femrave. Vitet 2004-2005 shfaqen dukshëm si vitet më të sukseshshëm përsa i përket ritmit të rritjes së numrit të nxënësve të diplomur, si pasojë e ndryshimeve të qeverive dhe ndryshimit në reformat arsimore.

Tabela 1. Numri i nxënësve të diplomuar për vitet 1992-2012, të ndarë në gjini dhe profile

Viti Shollor	Në Shkolla të Mesme			E Mesme e përgjithshme			E Mesme profesionale		
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj
	Total	Female	Male	Total	Female	Male	Total	Female	Male
1991 - 92	30616	16538	14078	11537	6879	4658	19079	9659	9420
1992 - 93	22846	13484	9362	9489	6205	3284	13357	7279	6078
1993 - 94	18223	10708	7515	9135	6065	3070	9097	6643	2454
1994 - 95	17062	9932	7130	13413	8554	4859	3644	1378	2266
1995 - 96	16549	9428	7121	12372	7837	4535	4177	1591	2586
1996 - 97	15892	8838	7054	12694	7622	5072	3198	1216	1982
1997 - 98	15218	8390	6828	12556	7508	5048	2662	882	1780
1998 - 99	17097	9003	8094	13604	7992	5612	3493	1011	2482
2000 - 01	18843	10201	8642	16337	9345	6992	2506	856	1650
2001 - 02	20069	10875	9194	16997	9885	7112	3072	990	2082
2002 - 03	22182	11750	10432	18842	10472	8370	3340	1278	2062
2003 - 04	24840	12683	12157	21348	11415	9933	3492	1268	2224
2004 - 05	29380	14766	14614	25106	13319	11787	4274	1447	2827
2005 - 06	27905	15143	12762	24433	13444	10989	3472	1699	1773
2006 - 07	28756	15679	13077	24303	13350	10953	4453	2329	2124
2007 - 08	31122	16971	14151	26255	14426	11829	4867	2545	2322
2008 - 09	34289	18698	15591	29460	16268	13192	4829	2430	2399
2009 - 10	34823	18727	16096	29984	16450	13534	4839	2277	2562
2010 - 11	40354	20094	20260	35553	18236	17317	4801	1858	2943
2011 - 12	40927	20801	20126	38083	19924	18159	2844	877	1967

Grafiku 1: Luhatja në përqindje e numrit të nxënësve të diplomuar në shkollat të mesme 1992-2012



Nga grafiku i mësipërm shihet qartë paqëndrueshmëria e numrit të nxënësve të diplomuar në shkollat e mesme të vendit. Ajo që vihet re dukshëm është një rënie prej 25.4% e numrit të të diplomuarve në arsimin e mesëm gjatë viteve 1993-1994, kjo për shkak të ndryshme, si migrimi drejt zonave më të zhvilluara dhe emigrimit të popullsisë për shkak të hapjes së kufijve me vendet e tjera. Këto ndikuan ndjeshëm kryesisht në lëvizjen dhe largimin e moshës së re. Luhatja më e madhe e ritmit të rritjes së të diplomuarve ka qënë në vitin shkollor 2004-2005 si pasojë e ndryshimeve që kanë ndodhur në reformat në arsim dhe të ndryshimeve në situatën ekonomiko-politike. Trendi i numrit të nxënësve të diplomuar në shkollat e mesme përgjithësisht ka qënë në rritje, por jo në ritme rritje të qëndrueshme, kjo edhe për shkak të uljes së numrit të lindjeve në familjet shqiptare të viteve 90’ e në vazhdim, liberalizimit të lëvizjes së individëve drejt vendeve perëndimore, etj.

Përveç informacionit të grumbulluar për nxënës të diplomuar në shkollat e mesme, do të trajtohet edhe shkalla e nivelit arsimor me nivelin e punësimit dhe papunësisë. Për të studiuar numrin e studentëve që kanë ndjekur arsimin e lartë dhe institucioni ku kanë kryer studimet, janë hartuar dhe plotësuar 200 anketa të cilat grumbullonin informacion rreth gjinisë, moshës, arsimit dhe punësimit. Nga përpunimi i këtyre të dhënave kemi arritur në këto përfundime sipas tabllës së mëposhtme:

Tabela 2: Të dhënat e marra nga 200 të anketuar në Tiranë

GJINIA		MOSHA (VJET)			SHKOLLA E MESME			SHKOLLA E LARTE			PUNËSIMI (INSTITUCION)		
F	M	15-19	20-25	26-30	Prgj	Prof	pa. shk	Pu	Pri	Pa. shk	Pu	Pr	Pa pune
81	119	19	129	52	103	68	29	79	46	75	81	38	81
40.5%	59.5%	9.5%	64.5%	26.0%	51.5%	34.0%	14.5%	39.5%	23.0%	37.5%	40.5%	19.0%	40.5%

Nga të dhënat e mësipërme mund të thuhet se nga të gjithë të anketuarit 40.5% ishin femra dhe 59.5% meshkuj, 9.5% e të cilëve ishin nga intervali 15-19 vjeç, 64.5% bënë pjesë në grupmoshën 20-25% dhe 26% prej tyre ishin nga 26-30vjeç. Nga 200 të anketuarit 85.5% e tyre kanë mbaruar një shkollë të mesme, nga ku 51.5% kanë mbaruar shkollë të mesme të përgjithshme, 34% e tyre kanë mbaruar shkollë profesionale dhe 14.5% e tyre nuk kanë mbaruar shkollë të mesme. Përsa i përket arsimit të lartë 39.5% e tyre kanë mbaruar arsimin e lartë në arsimin publik, 23% kanë mbaruar arsimin e lartë në IAL private dhe 37.5% e tyre nuk janë me arsim të lartë. Nga anketat 59.5% e tyre janë të punësuar, 40.5% në institucione private dhe 19% në institucione publike, ndërsa 40.5% e të anketuarve rezultuan të papunë gjatë periudhës së anketës.

3. Nevojat për të krijuar një Sistem të ri Arsimor Kombëtar

1. Duhet të krijohet një arsim publik sepse kjo është një e drejtë sociale universale që duhet të garantohet nga shteti falas dhe nga interesi i veçantë i orientuar drejt interesit të përbashkët.

2. Sistemi arsimor publik duhet të jetë falas, sepse arsimi është një investim social përveç se individual dhe arsimimi duhet të jetë një hapësirë falas pa ndërhyrje nga ana e të ardhurave familjare. Falas sepse ky është një kusht për realizimin e arsimit si një e mirë sociale publike.

3. Sistemi arsimor duhet të jetë demokratik dhe pluralist për formën profesionale dhe teknike që të kontribuoj tek ndërtimi i një ndërgjegje kombëtare sa më të denjë tek çdokush nga ne.

4. Të krijohet një sistem arsimor i cili për studentët me vlera të larta morale, solidariteti, tolerance, dhe me rezultate të shkëlqyera, në funksion të nevojave që ka vëndi të akordojë bursa ekselence për të përgatitur liderat e ardhshëm të vëndit.

5. Të garantoj liri mendimi për profesorët e mësuesit, por në të njëjtën kohë akademikët duhet të respektojnë objektivat e nxjerra nga ministria e arsimit.

Është koha që sot duhet të vendoset arsimi në zemrën e çdo qeverie e në këtë mënyrë të vendoset arsimi në pikën kryesore të buxhetit të shtetit për të cilin ka ardhur koha që nga 5 % fonde në arsim të kalojnë 8-10%. Në këtë mënyrë do të shërbehet të sotmes dhe të ardhmes së vëndit.

-Mënyra e shpërndarjes së kuotave në Arsimin e Lartë Publik

Aktualisht në Shqipëri sistemi i vlerësimit të ngarkesës së lëndëve brenda një dege të caktuar vlerësohet me kredite. Krediti, është një sistem i ri vlerësimi për matjen e ngarkesës mësimore në orë që një student i Arsimit të Lartë plotëson detyrimet për çdo lëndë. Përfshihet më tej puna e studentit në auditor, bibliotekë, shtëpi, provime e veprimtari të tjera, e matur kjo në orë, të quajtura "Pikë Krediti". Nga ana cilësore përvetësimi i dijeve matet me notë, nga ana sasiore niveli përcaktohet me pikët e kreditit. Kjo i lejon studentit të fitojë kualifikime dhe të kryejë studime në institucione


të ndryshme qofshin ato publike ose private. Por institucionet publike çdo fillim viti nxjerrin kuota, ose numër studentësh që do të pranohet në çdo Universitet dhe çdo degë studimi. Para se të dalin përgjigjet e maturantëve për të drejtën e studimit, qeveria ka vendosur edhe kuotat e pranimit që do të ketë secila degë në universitetet publike në Shqipëri. Kështu, Kuotat e përgjithshme të pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për një vit akademik ndahen si më poshtë:

- a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë.
- b) Kuota për program të ciklit të dytë të studimit.
- c) Kuota për transferim studimesh.
- ç) Kuota për shtetasit e huaj.
- d) Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit.
- e) Kuota për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit.
- ë) Kuota për të verbrit (të veçanta).
- f) Kuota për romët (ballkano-egjiptianë).
- g) Pesë studentët e vitit të parë, me rezultatet më të larta në plotësimin e kriteve të pranimit (pikët e fituara në sistemin meritë-preferencë), në programin e studimit përkatës, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Këtë përjashtim, në asnjë rast, nuk e përfitojnë studentët me notën mesatare të shkollës së mesme më të ulët se nota nëntë.
- h) Fëmijët e policëve të vrarë dhe invalidët, nuk paguajnë tarifën e shkollimit

Tabela 3: Shpërndarja e kuotave të pranimit në universitete publike 2009-2013

Viti akademik	Kuotat e shpallura	Cikli i parë	Cikli i dytë	Transferime	Shtetas të huaj
2009-2010	22.134	21.034	300	700	100
2010-2011	23.534	23.034	100	300	100
2011-2012	25.183	24.583	200	300	220
2012-2013	27.647	27.047	200	300	100
2013-2014	31.030	30.130	300	500	100


Grafiku 2: Luhatja në përqindje e kuotave në përqindje 2009-2013




Nga tabela e mësipërme shohim qartë se kuotat e pranimit të studentëve në universitetet publike për ciklin e parë të studimeve ndahen në kuota totale të pranimit, kuotat e studimeve në ciklin e parë, kuotat e pranimit në ciklin e dytë, kuotat në dispozicion për transferime në universitetet publike, kuotat për pranimin e shtetasve të huaj të ndjekin studimet në universitetet publike të Shqipërisë si edhe kuota për student me aftësi të kufizuar ose që i përkasin pakicave kombëtare. Përsa i përket Institucioneve të Arsimit të Lartë Privat nuk kemi kufizime në numrin e të regjistruarve dhe specifikimeve të mësipërme.

Nga tabela vëmë re se ritmi i rritjes së kuotave të pranimit nga njëri vit në tjetrin ka ardhur duke u rritur, rritje kjo e cila pasqyrohet kryesisht në kuotat e ciklit të parë të studimeve për studentët vendas. Koordinimi i madhësisë së kuotave bëhet në përputhje me politikat arsimore, me treguesit makroekonomikë dhe në përputhje me faktorët politik, të cilët brenda një periudhe 23 vjeçare kanë ndërmarrë politika herë nxitëse e herë frenuese lidhur me reformat në arsim. Më poshtë paraqitet grafikisht numri i studentëve ndër vite i ndarë edhe sipas gjinisë.


Grafiku 3: Numri i studentëve gjithësej të regjistruar në universitete gjatë viteve 1994-2012



Grafiku 4: Studentë të regjistruar në universitete publike në vitet 1994-2012




Grafiku 5: Luhatja e numrit të studentëve të regjistruar në universitetet publike 1994-2012



Nga paraqitja tabelore dhe grafike e mësipërme shohim se vitet 1996-1997, 2004-2005 dhe 2009-2010 janë vitet me ritmin e rritjes së rregjistrimeve më të lartë në universitetet publike, kjo mund të ketë ardhur si pasojë e reformave të ndjekura dhe kushteve ekonomike të vendit. Viti 1997 konsiderohet si një ndër vitet me paqëndrueshmëri sociale, politike dhe ekonomike më të lartë në 20 vitet e fundit. Ky fakt u shfrytëzua për të krijuar lehtësira në kushtet e pranimit të kandidatët e mundshëm në universitete, ndryshe nga arsimi i mesëm i cili në këtë periudhë shfaqte një rënie të dukshme të numrit të nxënësve të diplomuar, për shkak kjo të pasigurisë. Ndërsa vitet 2007-2008 konsiderohen si vitet me rënie të ritmit të rritjes së numrit të studentëve të rregjistruar në universitetet publike. Kjo ndodhi pasi përkoj edhe me periudhën kur lulëzuan një sërë institucionesh të Arsimit të Lartë Privat, që me ofertat e tyre tërhoqën një pjesë të mire të kontigjentit në treg. Gjithashtu për shkak të reformave që ndryshuan kushtet e pranimit në universitetet publike, duke futur sistemin e provimeve me zgjedhje. Për të bërë lidhjen midis rënies së të rregjistruarve në universitetet publike do shohim nëse për të njëjtën periudhë do të kemi ritme rritje në universitetet private.

Grafiku 6: Numri i të rregjistruarve në IAL Private 2003-2012



Grafiku 7: Luhatja e rregjistrimeve në IAL Private 2003-2012



Grafikët e mësipërm tregojnë numrin dhe prirjen e numrit të studentëve të rregjistruar në universitetet private që nga hapja e tyre në vitin 2003 e deri në vitin 2012. Shihet që në vitin 2006-2007 ka një ritëm të konsiderueshëm rritjeje krahasuar me universitete publike në përqindje. Studentët e IAL publike vazhdojnë të kenë numrin më të madh të studentëve në degët përkatëse. Por nëse do të lejohet hapja në masë e IAL Private do ta kthejmë arsimin në një treg konkurrencial ku tarifat e pranimit në IAL Private do të rezultojnë më të ulëta se tarifat publike, kjo do të jetë shkas për rritjen e vazhdueshme të studentëve të rregjistruar në privat duke çuar kështu në studentë të një cilësie të ulët, që do ta kenë të vështirë të përballen me kushtet e tregut të punës.

4. Lidhja e nivelit arsimor me nivelin e punësimit

Tregu shqiptar i punës karakterizohet nga disa probleme për të cilat po merren masa të cilat duhet të ndikojnë drejtë-përsëdrejti në përmirësimin e situatës së këtij tregu që do të sjellë si pasojë rritjen e nivelit të punësimit. Ndër to mund të përmendim:

1. Përmirësimi i klimës së biznesit në kuadrin e reduktimit të taksave sidomos për biznesin e vogël si dhe ulja e masës së kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore.

2. Hapja e vendeve të reja të punës në sektorin privat jobujqësor me më shumë produktivitet dhe me pagë më të lartë përbën një element të rëndësishëm për uljen e varfërisë dhe përmirësimin të standartit të jetesës.

3. Tregu shqiptar i punës vuan akoma nga një nivel i lartë i tregut informal. Për më tepër ka pak lëvizshmëri ndërmjet sektorit informal dhe atij formal. Sigurimi i stimujve është më i favorshëm për formalizmin e vendeve të punës, kontraktimi më fleksibël do të ndihmonte në mënyrë të vaçantë të punësuarit.

4. Personat me nivel arsimor të ulët ndeshen me probleme të konsiderueshme në tregun e punës. Ka një përqëndrim të personave me arsim minimal apo paarsim në sektorin informal. Niveli i arsimimit është i lidhur ngushtë dhe me nivelin e të ardhurave. Zgjerimi i aksesit për arsimin dhe formimin profesional është shumë i rëndësishëm. Në të ardhmen, me urbanizimin e ekonomisë dhe largimin e saj nga sektori bujqësor, zhvillimi i kapitalit njerezor do të marrë një rendësi akoma më të madhe.


5. Megjithëse emigracioni është konsideruar si si një burim mjaft i mirë të ardhurash për familjet shqiptare dhe instrument i dobishëm në manaxhimin e riskut ai nxit fenomenin e qarkullimit të trurit. Qarkullimi i trurit ofron përfitime potenciale për të ardhmen sepse emigrantët kanë përfituar formim profesional dhe përvojë në vendet e emigrimit.


6. Femrat vazhdojnë të kenë nivele të ulëta punësimi dhe nivele të larta papunësie. Pagat për femrat janë 35% më të ulëta se sa ato për meshkuj, duke patur parasysh këtu moshën, arsimimin dhe karakteristika të tjera personale. Ndërsa niveli i papunësisë në komunitetet e romëve është rreth 70% dhe pjesa e atyre që janë të punësuar përgjithësisht marrin paga shumë të ulëta dhe shpesh janë të punësuar në punë me rreziqe në sektorin informal. Kjo ka pasoja negative në përgjithësi dhe ndikon në mirëqënien sociale të këtyre grupeve.

Të rinjtë shqiptarë duket se e kanë më të vështirë të gjejnë një punë, duke pasur një tendencë të njëjtë, me disa shtete të eurzonës (kryesisht ato që po e ndjejnë më shumë krizën, si Greqia, Spanja apo Italia). Sipas anketës së forcave të punës për vitin 2011 të INSTAT, të botuar së fundmi, shkalla e papunësisë tek të rinjtë mes moshës 25 deri në 34 vjeç është 16.6%, më e larta nga të gjitha grupmoshat e tjera, përveç asaj 15-24 vjeç, ku kjo normë është 23.4%, për shkak se një pjesë e madhe e të rinjve të kësaj moshe vazhdojnë shkollën. Për të gjithë grupmoshat nga 15 në 64 vjeç, shkalla e papunësisë rezulton 13.9%.

Edhe shkalla afatgjatë e papunësisë, për të rinjtë, grupmoshën 25-34 vjeç është më e larta (duke përfshirë sërish grupin nën 24 vjeç), prej 12.5%, nga 10.2% që është mesatarja afatgjatë e papunësisë për të gjitha grupmoshat. Grupmosha nga 35-44 vjeç rezulton se ka nivelin më të ulët të papunësisë si afatshkurtër ashtu dhe afatgjatë, me përkatësisht 9.9 dhe 7.8%. Sipas rezultateve të Anketës së Forcave të Punës (AFP) 2011, 68.2 përqind e popullsisë në moshë pune në Shqipëri ishte aktive në tregun e punës (pra të punësuar ose të papunë). Femrat përbënin rreth 44 përqind të forcave aktive të punës. Shkalla e aktivitetit ekonomik varion në mënyrë të rëndësishme sipas gjinisë. Shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës për femrat ishte 60.3 përqind ndërsa për meshkujt ky tregues ishte 76.1 përqind. Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës ishte 46.5 përqind. Diferenca prej 21.7 përqind e shkallës së pjesëmarrjes në forcat e punës për grupmoshën 15-29 vjeç dhe grupmoshën 30-64 vjeç shpjegohet, sipas INSTAT, nga fakti që një përqindje e lartë e të rinjve janë duke ndjekur shkollën. Nga të dhënat e AFP 2011 rezulton që 65.7 përqind e të rinjve 15-29 vjeç nuk ishin pjesëmarrës në tregun e punës për arsye se ata ishin duke ndjekur shkollën. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet në vlerë absolute numri i të papunëve të regjistruar në vitet 2000-2013 të ndarë në gjini:

Grafiku 8: Të papunë të regjistruar për vitet 2000-2013



Grafiku 9: Nomra e papunësisë 1994-2013

Po të shohim grafikun e luhatjes së norms së papunësisë në vite vëmë re që periudhat me luhatje më të madhe të nomës së papunësisë kanë qënë vitet 1994-1999, kjo për shkak edhe të paqëndrueshmërisë ekonomike dhe politike në vend. Aktualisht jemi në norma papunësie dyshifrore, që krahasuar me inflacionin dhe rritjen ekonomike nuk është një tregues optimal. Përpjekjet e viteve të fundit nga Banka Qëndrore dhe Ministria e Financës për të pasur politika Monetare dhe Fiskale të përshtatshme me kushtet ekonomike-financiare të vendit, nuk kanë rezultuar shumë të sukseshme për vet faktin se jemi një vend në zhvillim dhe lind nevoja për më shumë koordinim midis politikave dhe institucioneve që hartojnë ose zbatojnë këto politika.

Konkluzione dhe Rekomandime

Konkluzione

Nga analiza e mësipërme konstatohet se treguesit kryesor të luhatjes së numrit të nxënësve të diplomuar, studentëve që kanë ndjekur ndër vite studimet e larta dhe norma e papunësisë nga viti 1992-2012 janë tregues të cilët janë ndikuar nga shumë faktorë ekonomik, social dhe politik, të cilët kanë ushtruar presion nxitës ose frenues në zhvillimin arsimor-edukativ. Sa më poshtë mund të nxjerrim këto përfundime:

1. Ndryshimi i sistemit me konkurs të maturantëve për konkurim në arsimin e lartë dhe kalimi në sistemin e provimeve me zgjedhje në vitin 2006 ishte një reformë arsimore e cila synonte përshtatjen e preferencave kryesore të kandidatëve, të ndërthurura me performacën e tyre ndër vite dhe pikëve të grumbulluara në provime si dhe me kuotat e miratuara nga MASH për secilën degë dhe për secilin fakultet. Por ky ndryshim solli një çrregullim në sistemin arsimor për shkak të kohës së shkurtër të informimit të grupeve të interesit si dhe mungesës së informacionit gjatë plotësimit të formularëve. Kjo bëri që një numër i madh studentësh të mos studioje

në degën e tij të preferuar por në degën ku ai kishte arritur pikët e duhura për tu shpallur fitues, dhe akoma më keq të mos ishte fitues në asnjë prej degëve të zgjedhura, duke ju drejtuar kështu mundësisë së ndjekjes së studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë Privat. Kjo ndikon së tepërmi në performancën e studentit gjatë studimeve të ciklit të parë dhe në përshtatjen e nivelit arsimor me kërkesat e tregut.

2. U kalua nga një sistem arsimor katër vjeçar ose nga Diploma e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND), në sistemin e arsimit të lartë sipas Kartës së Bolonjës, ku studenti paisëj me kredite (ECTS), të nevojshme në transferimin e studimeve brenda dhe jashtë vendit. Por aplikimi i një skeme të tillë bën që studentët të mos kenë formimin e duhur për tju përshtatur tregut të punës, duke kërkuar që të kryejnë studime shtesë, të cilat quhen studime të ciklit të dytë ose studime master, të ndara në master profesional dhe master shkencor. Duke qenë se për të ndjekur ciklin e dytë të studimeve në univesitetet publike duhet të përmbushen kritere dhe të paguhet një tarifë e konsiderueshme vjetore në varësi të degës, e cila ka ardhur duke u rritur vit mbas viti, studentët priren që këto studime ti kryejnë në universitete private, duke ngushtuar kështu mundësitë ekonomike familjare ose personale.
3. Aplikimi i detyrueshëm i mbrojtjes së gjuhës angleze para përfundimit të studimeve të ciklit të dytë në një nga institucionet ndërkombëtare që e ofrojnë këtë shërbim, që vlerësimi i tyre të njihet nga institucionet shqiptare, përveç se rrit njohuritë e studentëve ajo ka efekte negative sepse rrit kostot e studimit të ciklit të dytë dhe lë vend për abuzim nga ana e kompanive që e ofrojnë një shërbim të tillë. Duke qenë se janë sipërmarrje private fitimprurëse, priren gjithmonë për të pasur sa më shumë student që e japin këtë provim, pavarësisht nivelit që ata kanë. Kjo si reformë e re e ndërmarrë në arsim për të rritur cilësinë e studentëve që mbarojnë studimet në nivel master kthehet në një pikë të dobët në arsimin shqiptar për arsye të keqadministrimit nga kompanitë private që ofrojnë shërbimin.
4. Paqëndrueshmëria politike dhe ekonomike, janë dy faktorë të rëndësishëm të cilët ndikojnë dhe ndikohen nga niveli arsimor dhe reformat në arsim. Sa më e zhvilluar të jetë një ekonomi aq më shumë nevojë ka për punonjës të kualifikuar në pozicionet e duhura. Gjithashtu sa më të paqëndrueshëm të jenë dy faktorët e mësipërm aq më negative janë ndikimet që japin ndryshimet e reformave në këtë fushë.
5. Norma e papunësisë si një tregues i rëndësishëm makroekonomik, përveç ndikimit që i jep inflacioni dhe GDP-ja në rritjen ose në rënien e nivelit të saj, faktor i rëndësishëm në përcaktimin e sasisë dhe cilësisë së këtij treguesi është edhe niveli arsimor. Sa më i arsimuar të jetë një komunitet aq më i përshtatshëm është ai në zhvillimin e ekonomisë dhe në përputhje me kërkesat që ka tregu i punës. Por si i bëhet kur tregu i punës është i tejngopur me student të cilët kanë mbaruar studimet në degë të caktuara dhe janë pjesë e skemës së papunësisë? Këtu luan rol ndërthurja e elementëve makroekonomik me reformat arsimore në kuadër të përmirësimit të këtyre treguesve.

Rekomandime

Brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore sistemi arsimor ka pësuar ndryshime të konsiderueshme, si pasojë e nevojës së tregut, të fushës sociale, të kushteve ekonomike dhe politike të vendit. Në kuadër të përmirësimit të këtij sistemi bazuar dhe në të dhënat e grumbulluara rekomandojmë:

1. Të nxitet pjesmarrja në rregjistrimin e nxënësve në shkolla të mesme profesionale, në mënyrë që të kompensohen njohuritë e humbura nga zbatimi i sistemit të bolonjës. Duke mos qënë studentët të aftë të përballen me tregun e punës mbas përfundimit të ciklit të parë të studimeve. Kjo mund të arrihet vetëm duke krijuar reforma të përshtatshme arsimore dhe sistemin aktual të koeficientëve të shkollave të mesme në degët përkatëse, në mënyrë që të rritet numri i nxënësve që mësojnë në shkolla profesionale.
2. Ngritja sa më parë e një grupi kontrolli dhe riakreditimi i universiteteve kryesisht private, me qëllimin kryesor të vlerësimit të programeve dhe kurrikulave, infrastrukturës, teknologjisë dhe stafit akademik të institucionit, për të parë përputhshmërinë e kualifikimeve dhe moduleve që kanë në përgjegjësi. Duke lënë në tregun e Arsimit të Lartë Privat vetëm ato institucione të cilat përmbushin kriteret e mësipërme dhe që cilësia e ofrimit të këtij shërbimi të përafrohet me arsimin publik.
3. Mbrojtja e gjuhës angleze të mos kryhet nga institucione fitimprurëse por nga struktura shtetërore, të njëjta me AKP (Agjencia Kombëtare e Provimeve), në mënyrë që ky shërbim të vijë me kosto sa më të ulët për studentin dhe të jetë më efektiv në rezultatin e paraqitur, duke pasur kështu një standart të vetëm të pranuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo krijon premisa për marrëveshje midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në Shqipëri dhe vendeve kryesisht të rajonit.
4. Për të mos pasur kontigjent të kualifikuar më tepër se kërkesat e tregut, duhet të koordinohen politikat makroekonomike dhe reformat në arsim. Të përshtatet numri i kuotave me nevojat e tregut për specialitë në një fushë të caktuar. Ky nuk është ndonjë tregues i rëndësishëm në uljen e nivelit të papunësisë por është një element i cili mund të menaxhohet për të mos thëlluar më shumë hendekun midis të papunëve të pashkolluar dhe të papunëve me nivel arsimor të përshtatshëm me kërkesat e tregut.
5. Një reformë tjetër e rëndësishme që duhet të merret në arsim është aplikimi paraprak i reformave në një projekt pilot në mënyrë që të mos duken këto reforma si eksperimente shoqërore, të cilat çojnë në kushte neglizhence nga ana e nxënësve dhe studentëve.

BIBLIOGRAFIA

-Administrimi & Menaxhimi Arsimit. Nr3.2002 Tiranë

-Administrimi & Menaxhimi Arsimit. Nr5.2003 Tiranë

-Administrimi & Menaxhimi Arsimit. Nr1.2000 Tiranë

-Administrimi & Menaxhimi Arsimit. Nr2.2002 Tiranë

www.instat.gov.al

www.mash.gov.al

<http://www.panorama.com.al/2012/04/30/matura-dy-formulat-per-llogaritjen-e-pikeve/>

<http://gazeta-shqip.com/lajme/2013/07/03/sistemi-arsimor-ka-nevoje-per-revolucion/>